



Japan-World Bank Program  
for Mainstreaming Disaster Risk Management  
in Developing Countries



The Global Facility for Disaster  
Reduction and Recovery (GFDRR)



The World Bank Group

# PËRMIRËSIMI I INFORMACIONIT MBI RISKUN DHE HUMBJET NGA FATKEQËSITË NË SHQIPËRI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE  
MAJ 2022

Ky vlerësim u zhvillua me mbështetjen e Programit Japoni-Bankë Botërore për Integrimin e Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në vendet në zhvillim, i cili financohet nga Qeveria e Japonisë dhe menaxhohet nga Fondi Global për Reduktimin dhe Rimëkëmbjen nga Fatkeqësitë (GFDRR) përmes Qendrës së Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Tokio.

© 2022 International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank  
1818 H Street NW  
Washington DC 20433  
Telephone: 202-473-1000  
Internet: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Ky botim është produkt i personelit të Bankës Botërore me kontribute të jashtme. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore apo të qeverive që ata përfaqësojnë. Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave që përmban botimi. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe i gjithë informacioni tjetër që paraqitet në secilën prej hartave të përfshira këtu nuk nënkuptojnë asnjë lloj gjykimi të Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori apo mbështetje ose pranim të këtyre kufijve.

## LISTA E SHKURTIMEVE

Akronimet	Termet & përkufizimet
<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>AKMC</b>	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Ciovine
<b>ASIG</b>	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
<b>DBMS</b>	Sistemi i Menaxhimit të Fatkeqësive
<b>GFDRR</b>	Instrumenti Global për Reduktimin e Katastrofave dhe Rikuperimin, Banka Botërore
<b>GIS</b>	Sistemi i Informacionit Gjeografik
<b>GUI</b>	Graphical User Interface
<b>IGJEUM</b>	Instituti i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>OJQ</b>	Organizatë Jo-Qeveritare
<b>PBB</b>	Prodhimi i Brendshëm Bruto
<b>PDNA</b>	Vlerësimi i Nevojave pas Katastrofës

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Të ekspozuar ndaj rreziqeve natyrore të ndryshme duke përfshirë tërmetet, përmbytjet, rrëshkitjet e dheut, zjarret në pyje dhe thatësitë, Shqipëria përballet me një nga nivelet më të larta të rrezikut nga fatkeqësitë në Evropë. Përgjatë periudhës 1995–2015, mesatarisht 30,000 persona në vit janë prekur nga fatkeqësitë natyrore dhe më shumë se 95 për qind e bashkive shqiptare janë prekur të paktën nga një fatkeqësi. Në vitin 2019, një tërmet i magnitudës 6.4 goditi vendin, duke prekur mbi 200,000 persona në 11 bashki, përfshirë Tiranën e Durrësin. Sipas Vlerësimit të Nevojave të Pas- Fatkeqësisë (VNPF), tërmeti shkaktoi dëme të barabarta me 6,4 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të vitit 2018 dhe humbje të barabarta me një shtesë prej 1.1 për qind. Nëse nuk kontrollohen, ndikimi i fatkeqësive mund të rritet më tej si rezultat i ekonomisë në rritje, dhe ndryshimet klimatike mund të rrisin ashpërsinë dhe/ose frekuencën e fatkeqësive të lidhura me motin, të tilla si përmbytjet, zjarret dhe thatësitë.

Në korrik 2019, Shqipëria miratoi një ligj të ri për mbrojtjen civile, i cili prezanton një qasje moderne dhe progresive të menaxhimit të riskut. Mes shumë veprimeve kyçe, ligji përshkruan kërkesat që vlerësimet e riskut të kryhen në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal të paktën një herë në tre vjet, që institucionet dhe entitetet private të ofrojnë të dhëna të humbjeve nga fatkeqësitë dhe që të krijohet një bazë të dhënash për humbjet nga fatkeqësitë. Ndërsa vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbledhja e të dhënave të humbjeve janë kryer për shumë vite në Shqipëri, detyrimi sipas ligjit të ri formalizon kërkesat dhe formalizimet e palëve të përfshira, dhe synon të sigurojë që informacioni që rezulton të përdoret në mënyrë proaktive për të prioritarizuar, planifikuar dhe zbatuar menaxhimin e riskut. Ky raport ofron rekomandime, bazuar në vlerësimin e nevojave dhe mangësive, për aktivitete specifike për të vënë në praktikë kërkesat e ligjit, sipas praktikave më të mira botërore.

Ky Raporti Përmbledhës është produkti i fundit i projektit "*Përmirësimi i informacionit mbi rrezikun dhe humbjet nga fatkeqësitë në Shqipëri*", i përfunduar në mars 2022. Projekti u drejtua nga ekipi i Mott MacDonald dhe u përfundua në bashkëpunim me ekspertë vendas. Qëllimi përfundimtar i projektit është të kontribuojë në sigurimin e vendimmarrjes më të informuar të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri, duke mbështetur kështu Qeverinë Shqiptare për të përmirësuar informacionin kombëtar të riskut dhe humbjes nga fatkeqësitë, disponueshmërinë dhe qasjen ndaj informacionit të riskut nga rreziqet e shumëfishta dhe zhvillimin e një pasqyre kombëtare në lidhje me ato. Projekti u caktua si pjesë e Kolonës nr.2, nën asistencën teknike të Bankës Botërore për *Forcimin e Aftësisë Ripërtëritëse nga Fatkeqësitë në Shqipëri* (P172145) dhe u financua nga Programi i Japonisë dhe Bankës Botërore për Integrimin e Menaxhimit të Riskut prej Fatkeqësive në Vendet në Zhvillim (menaxhuar nga Fondi Global për Reduktimin e Fatkeqësive dhe Rimëkëmbjes - GFDRR).

Aktivitetet e projektit u ndanë në katër detyra kryesore:

**Faza fillestare** – me objektiva: identifikimin e burimeve dhe grupeve të të dhënave përkatëse; identifikimin e legjislacionit kombëtar përkatës; grumbullimin e njohurive mbi lidhjen dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe njësive qeveritare të përfshira, rrugën e informacionit mbi riskun dhe humbjen nga fatkeqësitë dhe strukturën e autoritetit; propozimi i sektorëve prioritarë për vlerësimin e humbjeve.

**Detyra 1** - Zhvillimi i një katalogu të të dhënave ekzistuese të riskut, të cilat janë të përshtatshme për territorin e Shqipërisë, nga burime vendase dhe ndërkombëtare.

**Detyra 2** - Sugjerimi i mënyrave për të përmirësuar qasshmërinë dhe aplikimin e informacionit ekzistues midis palëve të ndryshme të interesuara në lidhje me Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive.

**Detyra 3** - Zhvillimi i rekomandimeve për përmirësimin e grumbullimit, standardizimit, cilësisë dhe përfshirjes së informacionit të humbjeve nga fatkeqësitë, së bashku me një metodologji që do të përdoret në Shqipëri për vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve pas fatkeqësisë.

Janë mbajtur gjithashtu dy aktivitete me institucionet dhe njësitë qeveritare përkatëse, aktivitetet **për Konsultim dhe Miratim**, dhe reagimet e mbledhura prej tyre janë marrë parasysh në zbatimin e detyrave duke i përfshirë në dokumentet e dorëzuara. Përveç tyre, ekipi organizoi takime të tjera me përfaqësues nga institucionet përkatëse për të ndarë gjetjet kryesore të projektit dhe për të diskutuar së bashku aspekte të rëndësishme të punës së kryer.

Si pjesë e ekzekutimit të detyrave të projektit, u krye një analizë gjithëpërfshirëse mbi praktikën aktuale dhe legjisllacionin përkatës në Shqipëri për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave të lidhura me riskun, si dhe vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve pas fatkeqësisë. Kjo përfshinte:

- Rishikimin i përgjegjësive, kapacitetit të institucioneve dhe shkëmbimit të informacionit.
- Identifikimin e akteve ligjore, nënligjore dhe urdhëresave përkatëse në fuqi.
- Analizën e funksionimit dhe përdorimit të Gjeoportalit Kombëtar të mirëmbajtur nga ASIG.
- Rishikimin e sistemit DesInventar Sendai dhe përdorimi i tij në Shqipëri.
- Kërkimin e thelluar për të dhëna të lidhura me riskun, të përshtatshme për Shqipërinë.
- Rishikimin e praktikës së vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve pas fatkeqësisë në të shkuarën.
- Rishikimin e bazave të të dhënave për riskun dhe fatkeqësitë të cilat mirëmbahen aktualisht në Shqipëri.

Gjithashtu u krye dhe u raportua një rishikim dhe analizë e thelluar e platformave ndërkombëtare të të dhënave për informacionin përkatës, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi fatkeqësitë.

Rezultatet kryesore të projektit janë:

- Katalogu i të Dhënave të Risqeve, që përfshin me qindra grupe të dhënash përkatëse, të organizuara në një strukturë të qartë dhe të përshkruar me një sërë atributesh të paracaktuara të të dhënave.
- Metodologjia për mbledhjen dhe analizën e të dhënave pas fatkeqësive për aplikim të qëndrueshëm në Shqipëri, e zhvilluar në përputhje me legjisllacionin aktual vendas dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, dhe e ilustruar me tre shembuj të fatkeqësive natyrore të së kaluarës.
- Analiza e mangësive për të identifikuar sfidat me të cilat përballlet ende Shqipëria në mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave të rrezikut dhe zbatimin e ligjit të fundit 45/2019: "Për mbrojtjen civile".
- Një listë me 39 rekomandime të ndara në 7 kategori, për përmirësimin e qasjes dhe plotësimin e informacionit të lidhur me riskun, cilësinë dhe thellësinë e vlerësimit të humbjeve pas fatkeqësisë.

## Katalogu i të dhënave të riskut - "Risk data catalogue.xlsx"

Objektivat kryesore të Katalogut të të Dhënave të Riskut ishin: 1) mbledhja dhe rishikimi në një masë të caktuar të një game të gjerë burimesh dhe grupesh të dhënave të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut dhe riskut për Shqipërinë dhe 2) ndërtimi i një taksonomie të të dhënave të riskut, me përkufizime dhe strukturë të qartë për të mundësuar aplikim të qëndrueshëm në të ardhmen, në përputhje me klasifikimet e të dhënave ndërkombëtare që përdoren zakonisht. Pika e dytë u konsiderua jashtëzakonisht e rëndësishme dhe iu kushtua një vëmendje e veçantë. Një nga avantazhet kryesore të katalogut është struktura dhe përkufizimet e tij. Struktura është e lehtë për t'u përdorur, fleksibël për modifikim, në përputhje me burimet kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave dhe e përcaktuar qartë. Struktura dhe përkufizimet e propozuara mund të përdoren si bazë për zhvillimin e një taksonomie kombëtare të standardizuar për të dhënat e riskut, të mbështetur nga kuadri ligjor përkatës, së bashku me udhëzimet për ndërlidhjen midis përkufizimeve të katalogut dhe atyre të përdorura tashmë nga sistemi *DesInventar Sendai*, legjislativonin në fuqi dhe specifikimet e vendosura nga ASIG si standard vendor për grupet e të dhënave hapësinore dhe shërbimet.

Objekti i katalogut janë të dhënat që lidhen me vlerësimin e riskut për shkak të rreziqeve natyrore, dhe të zbatueshme vetëm për rastin e Shqipërisë. Rreziqet antropogjene janë jashtë fushëveprimit, por të tilla mund të përfshihen lehtësisht në të ardhmen, pa ndryshim konceptual të strukturës. Të dhënat e lidhura me riskun i përfshin të dyja, si të dhënat që lidhen drejtpërdrejt me riskun, edhe të dhënat që nevojiten për aplikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në vlerësimin e analizës së riskut. Përfshihen të dhënat jo të besueshme ose të dhënat jo të përshtatshme për Shqipërinë. Katalogu merr në konsideratë burime kombëtare dhe ndërkombëtare. Qindra grupe të dhënash përfshihen dhe përshkruhen me anë tëtributeve të paracaktuara. Ndërkohë, nuk ishte e mundur të kryhej një kontroll dhe verifikim i plotë i çdo grupi të dhënash. Megjithatë, zbatueshmëria e disa prej grupeve të të dhënave u vlerësua bazuar në përvojën dhe rishikimin e nivelit të lartë.

Katalogu u përgatit në një format të thjeshtë dhe të lexueshëm nga pajisjet. Ai është një tabelë Excel, ku informacioni mund të filtrohet dhe kërkohet lehtësisht. Gjithashtu, informacioni mund të eksportohet lehtësisht në formate të tjera skedarësh, si dhe të lexohet nga shumëllojshmëria e programeve kompjuterike të zakonshme.

## Metodologjia për mbledhjen dhe analizën e të dhënave pas fatkeqësisë

Metodologjia e propozuar kombinon qasje të ndryshme dhe mund të përdoret për lloje të ndryshme fatkeqësish, duke përshtatur shtrirjen dhe hapat bazuar në specifikat e ngjarjes së rrezikshme. Ai u përpilua bazuar në një rishikim të thellë të praktikave më të mira ndërkombëtare, praktikave aktuale në Shqipëri dhe sfidave me të cilat përballen ekipet dhe institucionet e përfshira.

Hapat e ndryshëm të metodologjisë janë të strukturuar përgjatë një afati kohor, nga momenti kur regjistrohet një ngjarje katastrofike deri në përfundimin e strategjisë së rimëkëmbjes. Rrjedha e punës së metodologjisë ndjek 21 parametra të ndarë në katër grupe: Identifikimi dhe karakterizimi i rrezikut; Identifikimi i zonës së prekur; Vlerësimi paraprak pas fatkeqësisë dhe vlerësimi i humbjeve; dhe Vlerësimi i plotë pas fatkeqësisë dhe vlerësimi i humbjeve. Nëse do të nevojiten të gjithë parametrat, dhe nëse disa nga aktivitetet do të shpërfillen ose do të bashkohen, kjo do të varet nga rasti, shkalla e fatkeqësisë, objektivat e vlerësimit, burimet në dispozicion për të përfunduar procesin e vlerësimit dhe faktorë të tjerë.

Renditja e hapave fillon me analizat parashikuese analitike në dy ditët e para pas një ngjarjeje të rrezikshme bazuar në të dhënat e disponueshme përpara fatkeqësisë dhe/ose të dhënat dixhitale të marra menjëherë pas fatkeqësisë (regjistrimet, parametrat e monitoruar, imazhet satelitore). Ai vazhdon me verifikimin, plotësimin dhe përditësimin e rregullt të vlerësimeve bazuar në vëzhgimet në terren dhe të dhënat e anketimit. Nëse procesi i anketimit ngadalësohet ose nuk mund të ekzekutohet plotësisht për shkak të kushteve specifike, vlerësimi mund të bazohet kryesisht në analizën analitike duke rritur kompleksitetin dhe detajet e saj. Nëse anketat organizohen menjëherë dhe në mënyrë efikase dhe të dhënat në vend merren menjëherë pas katastrofës, atëherë analiza analitike mund të përdoret vetëm për të ofruar një kuptim të përgjithshëm të shkallës së fatkeqësisë dhe sektorëve më të prekur për të ndër marrë aktivitetet e emergjencës dhe ndihmës, si dhe për të lehtësuar planifikimin e anketës. Në çdo rast, përpunimi dhe analiza e të dhënave vazhdon gjatë gjithë vlerësimit. Nëse procesi i Vlerësimit të Nevojave Pas-Fatkeqësisë (PDNA) kërkohet dhe inicohet nga Qeveria, atëherë rezultati i vlerësimit mund të jetë raporti i plotë PDNA i përgatitur me përpjekjet e përbashkëta të ekipeve ndërkombëtare dhe vendore.

Në thelb të metodologjisë së propozuar është ideja që procesi i vlerësimit pas fatkeqësisë mund të lehtësohet shumë duke pasur shumë informacione përkatëse përpara ngjarjes, kjo si pjesë e një baze të dhënash kombëtare të mirëmbajtur dhe të përditësuar vazhdimisht lidhur me risqet. Kjo vlen jo vetëm për disponueshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave bazë, e cila duket të jetë një nga problemet më të zakonshme të hasura në vlerësimet e kaluara në Shqipëri, por edhe për modelet e riskut që mund të ndihmojnë vërtet në vlerësimin e shpejtë paraprak në dy ditët e para pas fatkeqësisë.

Mbledhja e të dhënave pas fatkeqësisë është e ndarë në dy pjesë: 1) Kërkimi «desktop» për burimet e të dhënave dhe mbledhja e të dhënave nga sensorë të largët dhe satelitë; dhe 2) sondazhet dhe zbulimi në terren. Mbledhja e të dhënave «desktop» praktikisht mund të fillojë menjëherë pas fatkeqësisë dhe ndihmon në përgjigjen e menjëhershme. Sidoqoftë, sondazhet në terren zakonisht fillojnë pas fazës fillestare të kërkimit dhe shpëtimit. Kjo sigurisht varet nga shkalla e ndikimit, por, në çdo rast, do të nevojitet pak kohë për mobilizimin dhe planifikimin e aktiviteteve të anketimit. Përgatitja dhe realizimi i anketave nuk është përfshirë në detaje në metodologjinë e propozuar. Janë trajtuar parimet kryesore dhe sugjerohen burime të dobishme për përgatitjen e pyetësorëve, megjithatë, përpunimi i një qasjeje hap pas hapi për ekzekutimin e anketave në terren është konsideruar jashtë qëllimit të projektit.

## **Analiza e Mangësive**

Analiza e mangësive ka marë parasysh disa aspekte që lidhen me menaxhimin e të dhënave të riskut dhe procesin e vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë në Shqipëri. U vu re se gati tri vjet pas zbatimit të Ligjit 45/2019: "Për mbrojtjen civile", shumë nga reformat dhe nismat e parashikuara nuk kanë ndodhur ende dhe autoritetet vendore dhe institucionet kombëtare ende përballen me shumë sfida në përmbushjen e përgjegjësive të tyre të përcaktuara nga Ligji. Ekspertiza dhe mjetet janë të shpërndara nëpër institucione të ndryshme, të cilat duket se nuk janë në një bashkëpunim efikas, të konsoliduara nga njësitë qeveritare që duhet të mbikëqyrin procesin e mbledhjes së të dhënave dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave për dëmtimet dhe humbjet pas ngjarjeve të rrezikshme natyrore ose të shkaktuara nga njeriu. Kapaciteti i bashkive është gjithashtu i pamjaftueshëm për rolin kyç që pritet nga ato të luajnë në vlerësimin e rrezikut, në hartimin e planeve lokale të emergjencës, në mbledhjen e të dhënave pas fatkeqësisë dhe vlerësimin e humbjeve, në zhvillimin e planeve të investimeve për parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë, në menaxhimin e sistemeve të monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm

dhe të ngjashme me ato. Për më tepër, nëpërmjet Prefektit të QARK-ut, ata janë përgjegjës për gjenerimin e të dhënave lidhur me riskun dhe humbjen, të cilat duhet të sigurohen AKMC-së, e cila do të krijojë dhe operojë Bazën Kombëtare të të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë. Sipas ligjit, të dhënat e riskut dhe humbjeve nga fatkeqësitë ekzistojnë në tri nivele - bashki, prefektura, ministri dhe institucione qendrore - dhe do të menaxhohen në nivel kombëtar nga AKMC.

Në praktikë, nuk është e disponueshme një bazë e integruar kombëtare e të dhënave dixhitale të lidhura me riskun dhe ato pas fatkeqësisë me një strukturë të përcaktuar qartë, standarde dhe infrastrukturë të Teknologjisë së Informacionit, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Gjeoportali Kombëtar<sup>1</sup>, i zhvilluar dhe operuar nga ASIG, është aktualisht baza dixhitale e të dhënave për informacionin e gjeoreferencuar, por duket se është ende në fazën fillestare të strukturimit dhe harmonizimit, me një numër mjaft të kufizuar grupesh të dhënash dhe funksionesh të cilat kanë nevojë për përmirësim. Gjeoportali përmban grupe të dhënash të dobishme për vlerësimet e riskut dhe rrezikut, por të dhënat janë ende të pamjaftueshme për zhvillimin e modeleve të riskut dhe kryerjen e plotë të vlerësimeve gjithëpërfshirëse të riskut nga rreziqet e shumëfishta. Sa i përket të dhënave të fatkeqësive, e vetmja bazë e të dhënave e unifikuar që përdoret aktualisht në Shqipëri është *DesInventar Sendai*, e cila përmban përmbledhje të pasojave pas ngjarjeve. Megjithatë, përdorimi i *DesInventar*, nuk rregullohet nga Ligji 45/2019 ose legjislacioni përkatës, kështu që rregullat për përditësimin dhe futjen e të dhënave nuk janë të përcaktuara. Bashkitë dhe prefekturat herë pas here përgatisin, publikojnë dhe ruajnë raporte të veçanta për fatkeqësitë, por ato nuk mbledhen dhe menaxhohen në mënyrë sistematike në të gjitha bashkitë. Gjithashtu, ekzistojnë grupe të dhënash të dobishme të përpiluara rregullisht nga institucione të ndryshme, të cilat nuk kanë arritur në Gjeoportali, ose thjesht nuk janë menduar kurrë të ngarkohen në platformën e ASIG. Si përfundim, nuk është krijuar ende një bazë e të dhënave kombëtare e përbashkët e mirëstrukturuar për të përpiluar, unifikuar dhe administruar të gjitha grupet e të dhënave të disponueshme dhe krijimi i të dhënave të reja.

Pavarësisht numrit të madh të grupeve të të dhënave në Katalogun e të Dhënave të Riskut të listuara si të dobishme për vlerësimet e riskut në Shqipëri, informacioni nuk do të ishte i mjaftueshëm për analiza të besueshme të vlerësimit të riskut. Mungojnë grupe të dhënash të rëndësishme, shumë prej tyre nuk janë gati për aplikim të drejtpërdrejtë, disa nuk janë gjeoreferencuar dhe të tjerat ende duhet të kontrollohen dhe verifikohen përpara aplikimit. Disa nga mangësitë kryesore të identifikuara gjatë shqyrtimit të të dhënave janë: të dhëna të gjeoreferencuara me një rezolucion të mjaftueshëm për vendndodhjen dhe madhësinë e aseteve të ndryshme në të gjithë Shqipërinë dhe vlerën e ekspozuar të tyre; informacion për aplikim në analizën e rrezikut për llojet e rrezikut të ndryshëm nga tërmetet dhe përmbytjet; modelet e cënueshmerisë të zhvilluara për specifikat e aseteve në vend; informacion i rëndësishëm për analizën e kapacitetit të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë.

Sa i përket vlerësimit të humbjeve dhe dëmeve nga fatkeqësitë, nuk disponohet një metodologji kombëtare gjithëpërfshirëse për aplikim të qëndrueshëm në të gjithë Shqipërinë. Kjo përfshin: një standardizim më të gjerë të termave, përkufizimeve dhe strukturës së të dhënave që duhet ndjekur nga të gjithë aktorët e përfshirë në proces; udhëzime praktike për mbledhjen e të dhënave dhe planifikimin e procesit të vlerësimit; formularët shembull të vëzhgimit në terren për sektorë dhe mjetet e nevojshme për t'u përdorur nga bashkitë dhe prefekturat për mbledhjen e të dhënave. Rishikimi i vlerësimeve të humbjeve dhe nevojave nga fatkeqësitë e kaluara, që janë kryer në Shqipëri dëshmojnë se në shumicën e rasteve janë kryer vlerësime të thjeshtuara, me një shtrirje të kufizuar, kryesisht për qëllime zhdëmtimi dhe shpesh duke

<sup>1</sup> [Kryefaqe | ASIG Geoportal](#)



nënvlerësuar ndjeshëm humbjet e përgjithshme. Vetëm dy vlerësime janë kryera bazuar në metodologjinë e Vlerësimit të Nevojave Pas-Fatkeqësisë (PDNA) – e para, pas përmytjes në nëntor 2015 dhe tjetra, pas tërmetit të nëntorit 2019. Mangësi u identifikuan edhe me organizimin dhe menaxhimin e procesit të vlerësimit. Në shumë raste koordinimi ishte joefikas, personat e përfshirë nuk kishin trajnimin dhe përvojën e nevojshme, ministritë nuk ishin të përgatitura, mbledhja e të dhënave nuk ishte e planifikuar mirë, të dhënat e mbledhura nuk ishin verifikuar dhe rezultatet nuk ishin transparente.

## Rekomandime

Mangësitë e identifikuara u trajtuan me një sërë rekomandimesh për përmirësimin e procesit mbi mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave të lidhura me riskun dhe vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve pas fatkeqësisë. Për qartësi, rekomandimet janë grupuar në shtatë kategori, dhe ato duhet të merren parasysh së bashku gjatë planifikimit të masave dhe prioritizimit të aktiviteteve.

## Përmirësimi i funksionimit, qasshmërisë dhe aplikimit të Gjeoportalit

**Rekomandimi 1 Përfshirja në Geoportal i mjeteve për krijimin e hartave dixhitale inteligjente, të cilat mund të analizohen, kërkohen dhe paraqiten lehtësisht.** Kjo do të përmirësonte vërtet përdorshmërinë dhe madje edhe qasjen ndaj të dhënave, nëse futen më shumë mjete për trajtimin interaktiv të të dhënave, si: menaxhimi i shtresave të të dhënave (shpërbërja, bashkimi, kryqëzimi, etj.), analiza e modeleve hapësinore (llogaritja e densitetit, gjetja e pikave kritike, etj.), analiza statistikore (bashkoni veçoritë, përmbliidhni, grumbulloni, etj.), Analiza raster (analizoni imazhin, shndërroni veçorinë në raster, nxjirrni raster, etj.) dhe të ngjashme me to.

**Rekomandimi 2 Përmirësimi i ndërfaqes grafike të përdoruesit (GUI) dhe infrastrukturën e të dhënave hapësinore.** Çdo GUI vjetërsohet me kalimin e kohës ndaj kërkon mirëmbajtje të rregullt. Përditësimi i GUI të Gjeoportalit do të përmirësonte ndjeshëm funksionimin dhe aksesueshmërinë e tij.

**Rekomandimi 3 Përmirësimi i cilësisë dhe prezantimit të grupeve të të dhënave.** Disa nga grupet e të dhënave ishin të vështira për t'u lexuar dhe interpretuar. Disa imazhe raster kanë një rezolucion mjaft të ulët dhe legjenda të koduara, të cilat janë të vështira për t'u kuptuar, përveç nëse kërkohen burimet origjinale. Investimi në dixhitalizimin e imazheve raster dhe përkthimi i grupeve të të dhënave në anglisht, aty ku është e mundur, do të ishte gjithashtu shumë i dobishëm.

**Rekomandimi 4 Përcaktimi i qartë i niveleve të aksesit në Gjeoportal.** Pritet që Gjeoportali të ketë nivele të ndryshme aksesit, veçanërisht nëse të dhënat do të ngarkohen dhe modifikohen automatikisht nga ofruesit/zotëruesit e të dhënave. Aktualisht, nuk është e qartë se cilat janë nivelet e aksesueshmërisë, cilat janë grupet e të dhënave me akses të kufizuar, a ka të dhëna që nuk mund të shkarkohen as nga një përdorues i regjistruar dhe kush mund të kërkojë akses në të dhënat e kufizuara.

**Rekomandimi 5 Lehtësimi i procesit të marrjes dhe përditësimit të të dhënave duke ndërtuar një sistem efikas të menaxhimit të bazës së të dhënave (DBMS).** Me fjalë të tjera, lejo zotëruesin e të dhënave të ngarkojë, modifikojë dhe përditësojë të dhënat drejtpërdrejt në Gjeoportal. Kjo nuk do të thotë që të dhënat do të publikohen pasi të ngarkohen pa asnjë kontroll apo konfir-

mim. Është thjesht një mënyrë më e shpejtë për ngarkimin dhe përditësimin e informacionit dhe vetë publikimi është një proces i ndryshëm që do të varet nga ASIG dhe rregulloret që ai ndjek. Kujtesa automatike mund të programohet gjithashtu për t'u dërguar te siguruesit e të dhënave, në mënyrë që të ngarkojnë ose përditësojnë grupet e të dhënave për të cilat ata janë përgjegjës.

**Rekomandimi 6 Specifikimi i procesit për verifikimin dhe vërtetimin e të dhënave.** Aktualisht, i vetmi kontroll për të cilin është përgjegjës ASIG është përputhshmëria me Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor. Roli i ASIG në verifikimin e të dhënave të marra mund të zgjerohet me një sërë kontrollesh të kryqëzuara midis grupeve të të dhënave nga institucione të ndryshme, kontrolle për qëndrueshmëri dhe plotësueshmëri, të cilat nuk kërkojnë domosdoshmërisht ekspertizë në secilën fushë të të dhënave. Verifikimi dhe vërtetimi mund të jenë gjithashtu nën përgjegjësitë e një "ekipi të dedikuar" në AKMC, siç sugjerohet në Rekomandimin 21.

**Rekomandimi 7 Kryerja e kontrollit dhe verifikimit të grupeve të të dhënave të ngarkuara.** Për të përmirësuar besueshmërinë e informacionit të ngarkuar, mospërputhjet, paqartësitë dhe gabimet duhet të korrigjohen. Nëse është e nevojshme, rishikime shtesë mund të kërkohen zotëruesit e të dhënave. Nëse burimi i mospërputhjeve nuk mund të identifikohet dhe grupi i të dhënave nuk mund të korrigjohet, konfliktet e informacionit duhet të tregohen me shënime në grupet përkatëse të të dhënave.

**Rekomandimi 8 Rritja sa më shumë që të jetë e mundur e rezolucionit të të dhënave.** Nëse rezolucioni e të dhënave të disponueshme është shumë i ulët, ajo nuk mund të përdoret në vlerësimin e riskut dhe në vlerësimin pas fatkeqësisë. Qëllimi duhet të jetë mbledhja dhe ruajtja e të dhënave të lidhura me riskun në rezolucion sa më të lartë që të jetë e mundur dhe jo më i ulët se niveli më i ulët administrativ në dispozicion.

**Rekomandimi 9 Lidhja e Gjeoportalit me rrjetet për monitorimin e instrumenteve.** Të dhënat nga pajisjet e monitorimit (si ato të menaxhuara nga AKM dhe IGJEUM) mund të merren shumë lehtë në kohë reale dhe të përditësohen automatikisht, gjë që është një përparësi e madhe. Nëse të dhënat dixhitale të mbledhura nga pajisjet e monitorimit do të lidhen me një platformë dixhitale të integruar nën qeverisjen e AKMC-së, atëherë në rast fatkeqësie, do të kursehej kohë dhe do të reduktohej procedura administrative. Katalogu i të Dhënave të Riskut ka renditur disa burime të dobishme për të dhënat nga rrjetet e monitorimit.

**Rekomandimi 10 Lidhja e Gjeoportalit me burimet ndërkombëtare.** Sa i përket burimeve ndërkombëtare, më të dobishmet do të ishin ato që mund të ofrojnë imazhe satelitore dhe të dhëna bazuar në analizën e imazheve satelitore. Të dhënat nga monitorimi satelitor dhe me radar mund të jenë vërtet të dobishme, veçanërisht për parashikimet afatshkurtra të ngjarjeve të rrezikshme, paralajmërimin e hershëm dhe vlerësimin e menjëhershëm të impaktit të fatkeqësive. Ekipi i ASIG konfirmoi se një lidhje e tillë është e realizueshme, nuk ka kufizime nga pikëpamja e legjislativitetit në fuqi dhe se tashmë e ka menduar një projekt të ngjashëm.

**Rekomandimi 11 Mbështetje për institucionet, bashkitë dhe prefekturat me udhëzime, formularë të thjeshtë për t'u përdorur dhe madje edhe mjete dixhitale për përpilimin e të dhënave.** Problemet me bashkëpunimin midis ASIG dhe institucioneve përgjegjëse për sigurimin e informacionit janë nga arsyet kryesore për numrin e kufizuar të të dhënave të disponueshme aktualisht në Gjeoportal. Një mënyrë për të trajtuar këtë problem është sigurimi i mbështetjes aktive për institucionet dhe bashkitë/prefekturat në përgatitjen e të dhënave. Gjithsesi, duhet

theksuar se sipas legjislacionit në fuqi, ASIG nuk pritet të jetë në komunikim të drejtpërdrejtë me prefekturat dhe bashkitë dhe kjo duhet të ndodhë përmes AKMC-së. Kështu, siç sugjerohet në Rekomandimin 21, me ndihmën e ASIG, ky rol do të mund t'i transferohej edhe një "skuadre të dedikuar" në AKMC.

**Rekomandimi 12 Promovimi i funksionalitetit të Gjeoportalit dhe shërbimeve ASIG për bashkitë dhe prefekturat.** Së bashku me mbështetjen për institucionet vendore, ASIG duhet të promovojë edhe shërbimet që ato ofrojnë dhe përdorimin e të dhënave tashmë të disponueshme në Gjeoportalin për bashkitë nga të cilat mund të përfitojnë, veçanërisht kur disa nga sfidat kryesore që bashkitë kanë vënë në dukje në përmbushjen e detyrimeve të tyre janë burimet dhe ekspertiza e pamjaftueshme. Siç u përmend tashmë, ASIG nuk pritet të ketë komunikim të drejtpërdrejtë me bashkitë dhe prefekturat. Ia vlen të hulumtohet nëse një lidhje e tillë e drejtpërdrejtë midis ASIG dhe institucioneve vendore do të çonte në një bashkëpunim më të mirë të punës në të dyja drejtimet.

## **Përmirësimi i mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave të lidhura me riskun**

**Rekomandimi 13 Krijimi i një bazë të integruar të dhënash kombëtare për risqet dhe rreziqet pas fatkeqësive.** Siç u përmend, një gjë e tillë nuk është aktualisht e disponueshme dhe informacioni i mbledhur nga institucione të ndryshme nuk administrohet nën një strukturë të unifikuar të të dhënave. Një bazë e tillë e integruar kombëtare e të dhënave nuk synon të zëvendësojë bazat e të dhënave të menaxhuara nga institucione dhe bashki të ndryshme, por të sigurojë një mjedis të përbashkët në të cilin grupet e ndryshme të të dhënave janë unifikuar sipas të njëjtit format dhe përkufizime. Baza e të dhënave mund të ketë gjithashtu nivele të ndryshme aksesueshmërie sipas rëndësisë së llojeve të ndryshme të informacionit. Një opsion për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një baze të integruar të dhënash kombëtare dixhitale është kjo që të kryhet nga një ekip i dedikuar me ekspertizën e duhur si pjesë e AKMC. Opsioni tjetër është të bazohet në ekspertizën GIS të ekipit të ASIG, të zgjerohet kapacitetet e tij në përputhje me rrethanat dhe të ndërtojë bazën e të dhënave nën funksionimin e ASIG, por përsëri nën qeverisjen e AKMC për të përmbushur kërkesat e ligjit.

**Rekomandimi 14 Përcaktimi i një taksonomie të dhënash me përkufizime të qarta për t'u përdorur për strukturimin e grupeve të të dhënave ekzistuese dhe krijimin e të dhënave të reja.** Një strukturë e qartë hierarkike është një domosdoshmëri për një bazë të dhënash në rritje dhe të përditësuar vazhdimisht. Një organizim i mirë i të dhënave i mban ato aktive për grumbullimin, përmirësimin, kontrollimin dhe rishikimin dhe e lehtëson përdoruesin kur kërkon dhe filtron nëpër grupe të shumta të dhënash. Ai gjithashtu ndihmon në identifikimin e grupeve të të dhënave që mungojnë dhe planifikimin e zhvillimit të tyre. Një taksonomi e të dhënave me përkufizime të qarta mund të përdoret si udhëzues për llojin e të dhënave që do të mbliidhen, për të mbajtur gjurmët e përditësimeve dhe datat e referencës dhe madje për të ndihmuar bashkitë të identifikojnë se çfarë ekspertize dhe mbështetje shtesë mund t'u nevojitet për të përfunduar detyrat e tyre në lidhje me zotërimin e të dhënave të lidhura me riskun. Struktura që ne kemi propozuar për Katalogun e të Dhënave të Riskut mund të përdoret si bazë për klasifikimin e të dhënave në Gjeoportalin kombëtar. Theksi duhet të vihet në përkufizimin e të gjithë termave të përdorur për klasifikimin e të dhënave dhe atributet e përdorura për të përshkruar të dhënat dhe metadatat.

**Rekomandimi 15 Planifikimi i përgatitjes dhe mbledhjes së të dhënave të nevojshme.** Një mjet shumë i dobishëm për të ndihmuar me këtë është Katalogu i të Dhënave të Riskut i zhvilluar për

këtë projekt. Hapi i parë do të ishte identifikimi i grupeve të të dhënave që mungojnë, hapi i dytë do të ishte krijimi i një plani me qëllime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, së bashku me burimet e nevojshme, hapi i tretë do të ishte caktimi i përpilimit të grupeve të të dhënave të identifikuar për institucionet përkatëse, autoritetet vendore dhe ekipet kërkimore, dhe në fund, të dhënat e mbledhura duhet të integrohen në bazën e të dhënave kombëtare pas kontrollit dhe verifikimit për konsistencën, plotësueshmërinë dhe përputhshmërinë me standardet. Sipas ligjit, AKMC-ja jo vetëm që duhet të jetë në krye të këtij procesi, por edhe duhet ta mbikëqyrë atë dhe të ofrojë mbështetje me udhëzime, formularë të të dhënave dhe trajnime. KKT mund të jetë organi me ekspertizën e nevojshme për të mbështetur planifikimin e mbledhjes së të dhënave dhe për të ekzekutuar detyrat përkatëse.

**Rekomandimi 16 Mirëmbajtja e të dhëna të përditësuara për tarifën për njësi, koston e ndërtimit dhe zëvendësimin e llojeve të ndryshme të aseteve, koston e shërbimeve, etj.** Një nga sfidat më të zakonshme në vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë është vlerësimi i ekuivalentit monetar të dëmit dhe shërbimeve të cënuara. Arsyeja kryesore është se një informacion i tillë mungon në momentin e vlerësimit dhe supozime të ndryshme për plotësimin e këtij boshllëku përdoren nga ekipet sektoriale, gjë që çon në mospërputhje të rezultateve.

**Rekomandimi 17 Hulumtimi i burimeve lokale për të dhëna të dobishme.** Disa prej tyre janë deklaruar qartësisht si institucione që duhet t'i japin informacion ASIG-it për Gjeoportalin, të tjerë nuk pritët të përgatisin grupe të dhënash por në të njëjtën kohë mbledhin të dhëna të dobishme si pjesë e aktiviteteve të tyre. Një shembull i mirë për rastin e dytë është OSHEE, regjistri i adresave të të cilit është përdorur si më i përditësuar në vlerësimin e fundit pas fatkeqësisë pas tërmetit të nëntorit 2019. Në mënyrë të ngjashme, programet e financimit kombëtar dhe në vazhdim dhe projektet kërkimore mund të të jenë burime shumë të dobishme të dhënash.

**Rekomandimi 18 Hulumtimi i burimeve ndërkombëtare për të dhëna të dobishme.** Platformat ndërkombëtare të të dhënave janë më të vlefshmet për këtë lloj të dhënash që kërkojnë burime dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe janë krijuar si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta midis shumë vendeve dhe ekuipeve. Këtu përfshihen të dhënat e mbledhura nëpërmjet sensorëve dhe imazheve satelitore në distancë, të mbledhura nga rrjetet ndërkombëtare të monitorimit, të marra nga projekte të mëdha kërkimore ndërkombëtare, të mbledhura nga rikonjicione pas fatkeqësive dhe të ngjashme si këto. Katalogu i të Dhënave të Riskut përmban një listë të gjerë të burimeve të tilla që ia vlen të merren parasysh për bazën e grupeve të të dhënave të riskut.

**Rekomandimi 19 Përgatitja e modeleve të riskut dhe rrezikut dhe përfshini të dhënat e tyre hyrëse në bazën e të dhënave të lidhura me riskun.** Modelet dixhitale të riskut dhe rrezikut, ose më konkretisht inputet për to, duhet të përfshihen gjithashtu në përpilimin e të dhënave të lidhura me riskun. Shumica e tyre pritët të jenë projekte afatmesme deri në afatgjata të cilat do të kërkonin ekspertë të fushave të ndryshme, planifikim dhe investim të duhur. Në të njëjtën kohë, ato mund të jenë jashtëzakonisht të dobishme, jo vetëm për zhvillimin e profileve të riskut që duhet të ketë secila bashki, por edhe për vlerësimin e shpejtë të humbjeve dhe dëmeve pas fatkeqësisë.

**Rekomandimi 20 Mbështetje për bashkitë dhe prefekturat me shembuj Specifikimesh Teknike për mbledhjen e të dhënave.** Shumë nga bashkitë nuk kanë ekspertizën për të mbledhur dhe përpunuar të dhëna dhe ato ua japin aktivitetet e ndërlydhura të kompanive me përvojën e nevojshme. Kjo, megjithatë, shoqërohet me cilësi, standarde dhe qasje të ndryshme, gjë që e bën shumë të

vështirë integrimin e grupeve të të dhënave. Problemi mund të kapërcehet me shembuj të Specifikimeve Teknike me të gjitha kërkesat e nevojshme, të cilat institucionet vendore mund t'i përdorin në rast se kanë nevojë për mbështetje të jashtme për përpilimin e të dhënave që u kërkohet të sigurojnë.

**Rekomandimi 21 Ekipi i dedikuar për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave pas fatkeqësisë dhe riskut.** Një mënyrë për të përmirësuar procesin e mbledhjes, analizës dhe menaxhimit të të dhënave është sigurimi i një ekipi ekspertize të përbërë me përgjegjësi të përcaktuara qartë. Një opsion është forcimi dhe konsolidimi i kapaciteteve aktuale në AKMC në një ekip të dedikuar, pasi AKMC është agjencia kombëtare përgjegjëse për ngritjen dhe funksionimin e Bazës Kombëtare të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe ka në strukturën e saj sektorin e Bazës së të Dhënave për Humbjen nga Fatkeqësitë dhe Statistikat. Opsioni tjetër është të ndërtohet mbi ekspertizën GIS të ekipit të ASIG dhe Gjeoportalit tashmë ekzistues, dhe të krijohet një ekip i tillë i dedikuar nën qeverisjen e ASIG. Pritet që një ekip i tillë të luajë gjithashtu një rol kyç në vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve pas një fatkeqësie, menaxhimin e mjeteve dixhitale për mbledhjen e të dhënave gjatë procesit të vlerësimit, përgatitjen e raporteve të vlerësimit dhe përditësimin e grupeve të të dhënave në *Sistemin DesInventar*. Vetëm ekspertët e GIS nuk do të mjaftonin. Rekomandohen shumë specialistë të tjerë në fushat e analizës dhe statistikave të të dhënave, analizës së riskut dhe rrezikut, teknologjisë së informacionit, njohjes së imazheve dhe mësimit të paisjeve.

## **Kuadri ligjor, standardet dhe metodologjia për vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë**

**Rekomandimi 22 Aktet nënligjore të ligjit 45/2019.** Për sa i përket vlerësimit të humbjeve nga fatkeqësitë dhe të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, në hartimin e akteve nënligjore të ligjit 45/2019, si dhe në ndryshimet e ardhshme të tij, Akte Normativë me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019: "Për përballimin me pasojat e një fatkeqësie natyrore" duhet të merren parasysh dhe anasjelltas.

**Rekomandimi 23 Përmirësime të ligjit 45/2019.** Sqaroni në Artikullin 11, të ligjit se çfarë nënkupton "vetëqeverisja lokale" dhe nëse i referohet bashkive. Tregoni qartë periudhat brenda të cilave bazat e të dhënave duhet të krijohen dhe përditësohen – periudha të ndryshme mund të specifikohen për lloje të ndryshme të dhënash dhe disa periudha mund të lidhen me fushatat kombëtare për mbledhjen e të dhënave. Përcaktoni qartë procesin e kontrollit dhe verifikimit të grupeve të të dhënave të përgatitura dhe kush është në krye të këtij procesi. Siç sugjerohet nga Rekomandimi 21, kjo mund të bëhet nga një "ekip i dedikuar" brenda AKMC-së.

**Rekomandimi 24 Referenca në Ligjin 45/2019 për standardet e të dhënave.** Standardet dhe formatet e miratuara të të dhënave duhet të specifikohen qartë në Ligj. Deri në momentin e publikimit së standardeve kombëtare, një zgjidhje e përkohshme mund të jetë referimi në strukturat e të dhënave dhe përkufizimet e një prej metodologjive të pranuar ndërkombëtarisht të vlerësimit pas fatkeqësisë. Metodologjia dhe struktura e katalogut të propozuar në këtë projekt, e cila është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, janë një pikënisje shumë e mirë për zhvillimin e standardeve dhe metodologjisë kombëtare për mbledhjen, ruajtjen dhe analizën e të dhënave pas fatkeqësisë.

**Rekomandimi 25 Metodologjia e miratuar për vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve pas fatkeqësisë.** Rekomandohet shumë që të zhvillohet dhe publikohet një metodologji kombëtare për

vlërësimin e dëmeve dhe humbjeve pas fatkeqësisë për aplikim të qëndrueshëm në Shqipëri. Metodologjia e propozuar këtu mund të përdoret si bazë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet termave dhe përkufizimeve. Përgatitja e udhëzimeve dhe instruksioneve në mënyrë specifike për bashkitë dhe prefekturat. Sipas ligjit në fuqi, kjo duhet të jetë nën përgjegjësinë e AKMC-së.

**Rekomandimi 26 Forcimi i kontrollit mbi zbatimin e ligjit 45/2019.** Sigurohuni që bashkitë dhe prefekturat të mirëmbajnë bazat e të dhënave për dëmet dhe humbjet dhe ato të përditësohen rregullisht. Kjo mund të mbështetet edhe nga stimujt ose sanksionet për përmbushjen ose mospërmbushjen e kërkesave të ligjit. Sipas Artikullit 23 të Ligjit 45/2019, kjo është në kuadër të përgjegjësisë të AKMC-së.

## **Përmirësimi i procesit aktual të mbledhjes dhe analizës së të dhënave pas fatkeqësisë**

**Rekomandimi 27 Përcaktimi i strukturës dhe përgjegjësisë të një ekipi koordinues që do të aktivizohet pas një fatkeqësie për vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve.** Sipas Ligjit 45/2019, Neni 23, AKMC-ja është përgjegjëse për "koordinimin e përpjekjeve për ... dhe zhvillimin e Vlerësimin të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror". Megjithatë, ligji nuk specifikon më tej se si duhet të ekzekutohet ky koordinim dhe si duhet të strukturohet ekipi koordinues.

**Rekomandimi 28 Propozimi i formularëve të vëzhgimit në terren sipas sektorëve.** Disponueshmëria e formularëve të anketimit përpara fatkeqësisë do të lehtësonte vërtet procesin e vlerësimin dhe do të siguronte konsistencën midis ekipeve dhe institucioneve të ndryshme. Meqenëse kushtet dhe impakti ndryshojnë nga një ngjarje në tjetrën, formularët e anketimit nuk mund të bëhen të detyrueshëm ose të standardizuar, por ato mund të ndihmojnë vërtet me mbledhjen e të dhënave në vend, edhe nëse duhet të bëhen disa modifikime të caktuara pas testimit paraprak. Për zbatimin e saktë dhe të qëndrueshëm të formularëve, ato duhet të shoqërohen me udhëzime, shënime shpjeguese dhe madje edhe shembuj.

**Rekomandimi 29 Zhvillimi i aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave për vlerësimin në vend.** Aplikacionet për mbledhjen e të dhënave për pajisjet celulare mund të lehtësojnë vërtet procesin e anketave në terren. Ato ndihmojnë gjithashtu në gjeoreferencimin automatik të të dhënave dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me një bazë të dhënash GIS për ngarkimin, ruajtjen, pas-përpunimin dhe vizualizimin e të dhënave.

**Rekomandimi 30 Aplikimi i mjeteve «crowdsourcing».** Vlen të hulumtohen përfitimet e përdorimit të metodës "crowdsourcing" për mbledhjen e të dhënave menjëherë pas një fatkeqësie. Bazuar në përgjigjet e popullatës së cënuar, informacion shumë i dobishëm për shkallën e ndikimit mund të merret menjëherë pas ngjarjes së rrezikshme. Të dhënat e marra do të duhet të verifikohen, megjithatë informacioni do të jetë shumë i dobishëm për vlerësimin paraprak, planifikimin dhe koordinimin e ndihmës emergjente.

**Rekomandimi 31 Përcaktimi sa më shumë që të jetë e mundur i të dhënave bazë që në fillim të procesit të vlerësimin.** Kur më shumë se një ekip punon në vlerësim, është shumë e rëndësishme që të koordinohen ndërmjet ekipeve të dhënat bazë të disponueshme që do të përdoren, veçanërisht tarifrat dhe vlerësimet e kostos. Kjo do të garantojë qëndrueshmëri në rezultatet përfundimtare dhe do të lehtësojë vlerësimin e efekteve ndërsektoriale.

## Forcimi i kapaciteteve institucionale në procesin e vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve

### | Rekomandimi 32 Forcimi i kapaciteteve të bashkive dhe prefekturave

- AKMC duhet të mbështesë bashkitë dhe prefekturat në përgatitjen e instrumenteve për vlerësimin e dëmeve dhe humbjeve pas fatkeqësisë përmes udhëzimeve, formularëve dhe mjeteve të anketimit, trajnimeve për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave, fushata sqaruese mbi konceptin e ri të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, e përcaktuar në ligj dhe procesi aktual për raportimin e ndikimit, ngritjen e drejtpërdrejtë të kapaciteteve, si dhe financiarisht nëpërmjet kontraktimit të ekspertëve të jashtëm për përgatitjen e këtyre instrumenteve.
- AKMC gjithashtu duhet të përgatisë udhëzime dhe Rekomandime për krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për dëmet dhe humbjet; si të strukturohet baza e të dhënave, sa shpesh të përditësohet, si të përmbushen standardet kombëtare dhe të ngjashme me këto.
- Praktika ka treguar se zakonisht më shumë se 30 institucione të ndryshme janë të përfshira në koordinimin ose raportimin e informacionit mbi fatkeqësitë, dhe kjo krijon një parakusht për moskomunikim dhe bashkëpunim joefikas. Ndaj, është shumë e rëndësishme që të përcaktohen si duhet proceset e shpërndarjes së të dhënave dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, në mënyrë që raportimi të jetë i sinkronizuar dhe i detajuar ndërmjet nivelit lokal dhe atij kombëtar.
- Përcaktoni role dhe përgjegjësi të qarta për personelin e aftë për t'u marrë me vëllimin, kompleksitetin dhe larmishmërinë e informacionit për fatkeqësitë. Mund të jetë mjaft ambicioze të planifikohen 61 ekipe të pajisura plotësisht me të gjithë ekspertët e nevojshëm për komunë, prandaj roli i "ekipit të dedikuar" brenda AKMC-së, siç propozohet në Rekomandimi 21, do të ishte shumë i rëndësishëm. Për sa kohë që ekipet lokale janë të udhëzuara mirë se çfarë lloji të të dhënave duhet të mbledhin dhe cilat terma dhe përkufizime duhet të përdorin, atëherë formatimi i të dhënave bazuar në standardet dhe përpunimin GIS mund të centralizohet brenda përgjegjësisë të "ekipit të dedikuar".
- Kryeni trajnime në lidhje me *Sistemin DesInventar*. Aktualisht, bashkitë nuk kanë njohuri për këtë sistem, përcaktimet e përdorura prej tij dhe formatin e të dhënave për regjistrimin e dëmeve dhe humbjeve. Kuptimi i mirë i sistemit DesInventar prej ekipeve lokale do ta ndihmonte vërtet AKMC-në me përgjegjësinë e tyre për mirëmbajtjen e përditësuar të sistemit.
- Shtimi i burimeve të planifikimit dhe financimit për bashkitë mund të jetë i nevojshëm për të forcuar kapacitetet e tyre. Një nga vështirësitë më të zakonshme që bashkitë raportojnë është financimi i pamjaftueshëm. Financimi mund të jetë më i vështirë në rastin e prefekturave pasi ato nuk kanë ndonjë linjë buxhetore specifike për sa i përket Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë. AKMC duhet të rrisë ndërgjegjësimin për nevojën e krijimit të një programi buxhetor për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave të lidhura me risqet dhe fatkeqësitë në bashki<sup>2</sup> dhe prefektura.

<sup>2</sup> Sipas VKM Nr. 414, datë 8.7.2021: Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për ndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile:

3. Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të përdoret sipas prioritetëve, si më poshtë:

3.1. 60 (gjashtëdhjetë)% - 100 (njëqind)% e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për:

ç) ngritjen, përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave

**Rekomandimi 33 Bashkëpunimi me agjencitë ndërkombëtare që regjistrojnë dhe përpunojnë të dhënat pas fatkeqësisë.** Kjo vlen veçanërisht për agjencitë që kanë në dispozicion imazhe satelitore dhe regjistrime nga rrjetet ndërkombëtare me pajisje monitorimi dhe sensorë në distancë. Një shembull i mirë është programi Copernicus2 i koordinuar dhe menaxhuar për Komisionin Evropian nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Programin Hapësinor në partneritet me Agjencinë Evropiane të Hapësirës, Shtetet Anëtare të BE-së. Katalogu i të Dhënave të Riskut ofron agjenci të tjera të ngjashme, bashkëpunimi me të cilat do të ishte shumë i dobishëm jo vetëm për të dhënat, por edhe për analizën e të dhënave dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave. Sipas Ligjit 45/2019, Neni 23, "bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare dhe organizatat homologe ndërkombëtare në kuadër të mbrojtjes civile dhe zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë" është në përgjegjësinë e AKMC-së.

**Rekomandimi 34 Forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendore kërkimore dhe biznesin.** Bazuar në përvojën e këshilltarëve tanë lokalë dhe reagimet që morëm nga ekipi ASIG gjatë diskutimeve tona, arritëm në përfundimin se mund të ketë projekte të ndryshme përkatëse kërkimore në vazhdim të iniciuara nga universitete dhe institucione kërkimore, rezultatet e të cilave nuk kanë arritur në Gjeoportali dhe as tek ekipi i AKMC-së që është përgjegjës për menaxhimin e të dhënave. Kjo është arsyeja pse, do të ishte shumë e dobishme për AKMC-në dhe ASIG të kontaktojnë ekipet shkencore që punojnë në fusha të ngjashme dhe të krijojnë një bashkëpunim dypalësh me ta. Kjo vlen edhe për subjektet private mundësisht përmes degëve të organizatave profesionale.

## Sistemi *DesInventar Sendai* në Shqipëri

**Rekomandimi 35 Rregullimi i përdorimit të sistemit *DesInventar Sendai* me Ligjin 45/2019 ose legjisllacionin lidhur me të.** Përdorimi, menaxhimi, përditësimi dhe verifikimi i sistemit *DesInventar* duhet të përcaktohet qartë. Procesi, periudhat e përditësimit dhe institucionet përgjegjëse duhet të përcaktohen me urdhëresë, akt nënligjor ose direkt në ligjin 45/2019.

**Rekomandimi 36 Përgatitja e udhëzimeve për plotësimin e kartave të të dhënave.** Mospërputhjet e vërejtura në të dhënat për Shqipërinë të regjistruara në *DesInventar* tregojnë se konceptet dhe përkufizimet nuk janë të qarta, janë të çënueshme nga interpretimi dhe duhet të përcaktohen saktësisht në një dokument udhëzues me shembuj. Duhet të tregohet gjithashtu lidhja midis termave të përdorur në *DesInventar* dhe analogëve të tyre në legjisllacion dhe bazën e të dhënave kombëtare të fatkeqësive në të ardhmen.

**Rekomandimi 37 Rishikimi i të dhënave hyrëse të krijuara tashmë në sistem.** Shumë mospërputhje dhe gabime u vunë re në të dhënat hyrëse tashmë të disponueshme për Shqipërinë. Informacioni duhet të rishikohet dhe përmirësohet aty ku nevojitet në përputhje me kërkesat e *DesInventar*. Për rastet kur informacioni nuk mund të gjurmohet dhe verifikohet, duhet të sigurohet një shënim për të vlerësuar besueshmërinë e të dhënave.

## Përmirësime të shpejta

**Rekomandimi 38 Zgjerimi i pyetësorëve të përdorur në census.** Censusi është një nga procedurat e shkallës më të madhe për mbledhjen dhe regjistrimin sistematik të informacionit në lidhje me anëtarët e një popullate të caktuar. Legjisllacioni, rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e tij tashmë janë vendosur dhe buxheti është planifikuar në baza të rregullta. Kjo do të thotë se



me një investim shtesë shumë të vogël për zgjerimin e pyetësorëve të përdorur për të, censusi mund të mbledhë informacion shtesë jashtëzakonisht të vlefshëm për zhvillimin e modeleve të ekspozimit dhe cenueshmërisë. Inxhinierët dhe ekspertët e cënueshmërinë strukturore mund të përgatisin pyetje dhe kritere shtesë në lidhje me stokun e ndërtesës. Në mënyrë të ngjashme, ekspertë nga sektorë të tjerë mund të sugjerojnë informacion shtesë për t'u përfshirë në pyetësor. Për shembull, informacion teknik shtesë për ndërtesat e banimit si tipet dhe materiali strukturor, rikonstruktionet dhe rinovimi, mirëmbajtja, periudha e ndërtimit në lidhje me kodet historike të projektimit në Shqipëri, lloji i çatisë dhe fasadës, modifikimi pas ndërtimit të fasadës dhe të ngjashme me to.

**Rekomandimi 39 Prezantimi i formularëve të mbledhjes së të dhënave si pjesë e miratimit të projekteve të hartuara.** Gjithashtu, pritet që edhe kjo të jetë një masë shumë e thjeshtë dhe e lehtë për t'u zbatuar. Për çdo ndërtesë të re, objekt, infrastrukturë apo projekt gjeoteknik, mund të kërkohet një formular të dhënash me një grup parametrash të paracaktuar si pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm për miratimin dhe lejet e ndërtimit. Formulari i të dhënave mund të përfshijë, për shembull, vendndodhjen sipas koordinatave, vetitë e përgjithshme të strukturës, vitin e projektimit/rindërtimit dhe standardet e ndjekura të projektimit, qëllimin dhe jetëgjatësinë e projektimit, kapacitetin dhe numrin e banorëve, vetitë gjeoteknike të tokës dhe të ngjashme. Parametra të tillë mund të përdoren drejtpërdrejt për vlerësimin e riskut dhe rrezikut. Forma të ngjashme të dhënash mund të përdoren edhe në regjistrimin dhe dhënien e lejeve për sektorin prodhues, por sipas pritshmërisë sonë një proces i tillë i mbledhjes së të dhënave duhet të jetë tashmë i vendosur dhe i menaxhuar nga INSTAT.



Japan-World Bank Program  
for Mainstreaming Disaster Risk Management  
in Developing Countries



The Global Facility for Disaster  
Reduction and Recovery (GFDRR)



Mott MacDonald



The World Bank Group